



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 2.3.2016, ora: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama dhe Jelena Bontiq.

Munguan: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian, MAP, OSBE, ZRPK, KDI.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;**
- 3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme lidhur me Projektligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr. 05/L-031;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;

Procesverbali u miratua me një vërejtje,

Znj. Alma Lama, pati vërejtje që në procesverbal nuk janë inkorporuar të gjitha propozimet e saja nga mbledhja e kaluar, lidhur me propozim-ndryshimet në Ligjin për RTK-në.

3. Shqyrtimi i raporteve të Komisioneve të përhershme, lidhur me Projektligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nr. 05/L-031;

Zenun Pajaziti, ia dha fjalën nënkryetarit të parë z. Sadri Ferati, për të analizuar vërejtjet e Komisionit Parlamentar për Legjislacion, komision kryesor, në raportin me rekomandime të Komisionit Funkcional për Administratë Publike për Projektligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Sadri Ferati, nuk u pajtua me rekomandimin e Komisionit për Legjislacion që Projektligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative të kthehet, sepse komisioni ka punuar kohë të gjatë duke shqyrtuar Projektligjin nen për nen. Ka mbajtur takime me të gjitha grupet e interesit, me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë dhe duke konsideruar se janë konsumuar të gjitha debatet për çështjen, propozoi që nëse Komisioni për Legjislacion ka vërejtje konkrete për nene të caktuara, atëherë mund të diskutohet.

Sa i përket vërejtjeve për mungesën e përkufizimeve, ai tha se jemi përcaktuar që nuk janë obliguese pasi ato janë të inkorporuara në tekstin e Projektligjit për qëllim të thjeshtëzimit të procedurave administrative. Ferati kërkoi nga përfaqësuesit e MAP-së, që për vërejtjet e sipërshënuara, po qe se kanë sugjerime shtesë, të sjellin në komision në afat prej tri ditëve.

Xhevahire Izmaku, tha se janë konsumuar të gjitha debatet për Projektligjin dhe u deklarua se do të votojë për procedim të mëtutjeshëm.

Zenun Pajaziti, theksoi se komisioni nuk do të merret me vërejtjet për përkufizimet lidhur me Projektligjin dhe propozoi që Projektligji të votohet dhe të procedohet për Kuvend.

Alma Lama, tha se çështjet për të cilat ajo ka kundërshtuar që Projektligji nuk është hartuar sipas standardeve të përcaktuara për hartimin e një Projektligji, se nuk janë shqyrtuar vërejtjet e adresuara në komision për Projektligjin, veç sa janë kthyer në komision, dhe mbi bazë të këtyre arsyeve, ajo u deklarua se do të votojë kundër procedimit të tij në Kuvend.

Ndërsa, sa i përket propozimit të z. Sadri Ferati, që Ministria të sjellë sugjerime shtesë për Projektligjin, Lama e kundërshtoi këtë propozim me arsyetimin se MAP-ja e ka kryer punën e vet, kur e ka proceduar atë në Kuvend.

Përfaqësuesja e MAP-së, tha se përkufizimet në Projektligj nuk janë të domosdoshme, pasi që janë të cekura në nenet e tekstit të tij, ndërsa që vërejtje të tjera përmbajtësore nuk ka.

Konstatim: Komisioni miratoi kërkesën e z. Sadri Ferati, që për vërejtjet e sipërshënuara, po qe se kanë sugjerime shtesë MAP –ja ti sjell në komision në një afat prej tri ditëve.

4. Të ndryshme.

Zenun Pajaziti, propozoi që në takimin e radhës për plotësim- ndryshimin e Ligjit për RTK-në, të ftohen përfaqësuesit e ZKM-së, Zyrës së Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Ministrisë së Financave si dhe Bordit të RTK-së.

Komisioni miratoi njëzëri këtë propozim.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti